



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
LIPJANIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Mirlinda Beqiri Udhëheqës Ekipi dhe Naim Neziri Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
5 Qeverisja e mirë.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	31
Shtojca III: Letër konfirmimi	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/09/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Lipjanit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se në kuadër të prezantimit të llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 3.9 milionë €, përfshihen edhe të arkëtueshmet e bartura prej më shumë se pesë vitesh (LLA për taksat për leje afariste në vlerë 0.5 milion €) ku mundësia e inkasimit të tyre është minimale. Gjithashtu duke u nisur nga fakti që të hyrat nga tatimi në pronë përbejnë rreth 45% të hyrave të komunës, LLA nga kjo kategori kanë shënuar rritje prej 15%, që rrezikon financimet e ardhshme nga të hyrat e kësaj kategorie.

Me tutje, gjatë vitit 2017 dhe me parë komuna është paditur për shuma të konsiderueshme (mbi 600 mije €) nga ana e operatorëve ekonomik por edhe qytetarëve. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare. Komuna duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë trajtimit të detyrimeve kontingjente sidomos për njohjen dhe matjen e tyre.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës);
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar me gabimet si në vijim:

- Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit, komuna kishte prezantuar gabimisht edhe të hyrat indirekte nga gjobat dhe dënimet e trafikut;
- Neni 13, Raporti për LLA-të, llogaria e tatimit në pronë ishte mbivlerësuar për 37,042€; dhe
- Neni 17, Raporti për faturat e pa paguara ishte i mbivlerësuar, shuma totale e mbivlerësimit ishte 257,988€, fatura këto të cilat në të njëjtën kohë ishin shpalosur edhe si detyrime kontingjente.

Me pas komuna ka korigjuar pasqyrat e saj për gabimet e lartcekuar, duke përmirësuar raportimin e saj. Megjithëse, edhe pas korigjimit PVF-të përmbanin gabime teknike të shpalosjet, përkatësisht te neni, 14.6. Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, në të cilën komuna nuk ka prezantuar fondet e bartura për të hyrat në vlerë prej 757,608€, si dhe fondet e donacioneve të bartura në vlerë prej 22,525€. Kjo mandej është reflektuar edhe në kolonën e ndarjeve finale të buxhetit sipas SIMFK-së.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, pas korrigjimit dhe dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Lipjanit kishte shpenzuar 92% të buxhetit final për vitin 2017. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi janë me të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithëse ne kemi identifikuar disa parregullsi në aspektin e pajtueshmërisë.

Si pasojë e moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para, si dhe në vonesat në përfundim të projekteve. Fushat tjera ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i personelit, menaxhimi i pasurisë si dhe menaxhimi i obligimeve të papaguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	14,025,258	14,864,074	13,742,820	13,172,294	13,399,034
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,916,711	11,916,711	11,687,679	11,503,444	11,231,064
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	757,608	590,347	453,645	970,102
Të hyrat vetjake ³	2,108,547	2,108,547	1,383,836	1,137,530	943,666
Donacionet e brendshme	-	248	0	5,000	239
Donacionet e jashtme	-	80,960	80,958	72,675	253,963

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 838,816€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 81,208€, si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 757,608€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 13,742,819€, me një rënie prej 3% krahasuar me vitin 2016, ku norma e shpenzimeve ishte 95%. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm në disa kategori të shpenzimeve dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	14,025,258	14,864,074	13,742,820	13,172,294	13,399,034
Pagat dhe Mëditjet	8,772,802	8,819,570	8,650,049	8,711,706	8,538,950
Mallrat dhe Shërbimet	856,366	1,003,407	894,469	881,580	1,097,284
Shërbimet komunale	198,390	210,477	197,440	179,045	223,976
Subvencionet dhe Transferet	329,067	335,023	259,094	375,763	204,972
Investimet Kapitale	3,868,633	4,495,597	3,741,768	3,024,200	3,333,852

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit prej 626,964€ për shpenzime kapitale gjatë vitit, niveli i realizimit të buxhetit nuk ishte i mjaftueshëm (vetëm 83%). Programi për investime publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe disa projekte të reja për vitin aktual. Pjesa e mbetur e mjeteve të pashpenzuara të investimeve kapitale përfshinë mjetet e ndara nga të hyrat vetjake të cilat do të destinohen për financimin e projekteve kapitale në vitin vijues si rezultat i mos përmbushjes së planifikimit të të hyrave. Më tutje, një numër i konsiderueshëm i projekteve janë anuluar si pasojë e pagesave për vendime gjyqësore për paga dhe mëditje;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 46,768€, për mallra dhe shërbime për 147,041€ dhe për komunal për 12,087€, është rezultat i rekrutimit të një numri të ri të stafit. Buxheti final për këto kategori është rrit si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak; dhe
- Buxheti final i kategorisë së subvencioneve është rritur për 5,955€ për shkak të bartjes së të hyrave nga viti i kaluar, ndërsa norma e realizimit është vetëm 77%. Në normën e ulët të ekzekutimit të buxhetit ka ndikuar kryesisht mos përmbushja e programi për subvencione në bujqësi.

Çështja 2 - Realizimi i ultë i buxhetit për subvencione dhe investime kapitale

Realizimi i buxhetit arrin shkallën prej 92%, ndërkohë sfidë mbetet realizimi i jo i kënaqshëm i buxhetit për subvencione vetëm 77% dhe investime kapitale në 83%, duke bërë që disa nga objektiva e përcaktuara të mos arritën, dhe si të tilla ngarkojnë fondet buxhetore të vitit vijues. Kjo ka ndodhur sepse menaxhmenti nuk ka bërë analiza në baza të rregullta mujore mbi ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara. Më tutje, projektet⁴ janë anuluar si pasojë e vendimeve gjyqësore kryesisht për obligimet e pagave ndaj arsimtarëve të angazhuar në vitin 2013.

- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i tij rezultojnë me më pak projekt/përkrahje për qytetaret apo rrezikojnë arritjen e plotë të objektivave të synuara nga komuna.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të subvencionet dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm 2018.

Çështja 3 - Keq klasifikim i shpenzimeve si pasojë e pagesave me vendim gjyqësorë

- E gjetura** Pagesat me vendime gjyqësore (kryesisht për obligimet e pagave ndaj arsimtarëve të angazhuar në vitin 2013, botimet e publikimeve dhe projekti në zonat ekonomike në Kërçovë) janë ekzekutuar nga Thesari në vlerë prej 101,065€ të cilat kanë ndikuar negativisht në realizimin e projekteve dhe kanë mbivlerësuar kategorinë e investimeve kapitale. Një përqindje e vogël e mjeteve janë ekzekutuar edhe nga mallrat, shërbimet dhe shpenzimet komunale. Për më tepër, komuna nga 27 pagesa me vendimet gjyqësorë, ka paguar shpenzime shtesë në vlera prej 23,012€ për interesin, shpenzimet kontestimore, përmbarimit etj.
- Rreziku** Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve jep informata të gabueshme për shfrytëzuesit dhe për vendimmarrësin. Gjithashtu pagesat e tilla rezultojnë me shpenzim shtesë dhe rrisin rrezikun e arritjes së objektivave të përcaktuara.
- Rekomandimi 3** Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të planifikuar buxhet të mjaftueshëm krahas detyrimeve/obligimeve që pret komuna të përballët, për të ju dhënë prioritet shlyerjes së këtyre obligimeve me kohë, si dhe të prezantojë drejtë shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe natyrës reale të shpenzimeve.

⁴ "Asfaltimi i rrugës në fshatin Divjak", "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Leletiq", "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Jeta e Re" si dhe "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Rubovc i Vogël".

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Lipjanit gjatë vitit 2017 ishin në vlerë 1,611,018€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, taksa për leje ndërtimi dhe të hyra tjera. Pjesa më e madhe e të hyrave janë nga tatimi në pronë, në vlerë 457,667€.

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,108,457	2,108,457	1,611,018	1,808,065	1,453,652
Totali	2,108,457	2,108,457	1,611,018	1,808,065	1,453,652

Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë 197,048€, (120,747€ janë nga gjobat e gjykatave, si dhe 76,301€ nga pyjet dhe dënimet e policisë). Të hyrat vetjake prej 1,383,836€ janë shpenzuar për nevojat e komunës, kurse pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara në vlerë 470,750€ janë transferuar si suficit për tu shpenzuar në vitin 2018.

Çështja 4 – Nivel i ulët i verifikimit të pronave të regjistruara

- E gjetura** Bazuar në UA 03/2011, neni 13, zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar të bëjë verifikimin e 1/3 të pronave të regjistruara. Nga 2,535 prona, komuna kishte verifikuar vetëm 194 objekte, ose afro 8%. Lidhur me këtë ne kemi dhënë rekomandim edhe në vitin e kaluar, mirëpo edhe përpos zotimit nga ana e komunës ky rekomandim ka mbetur i pa zbatuar.
- Rreziku** Informacioni aktual mund të mos jetë i saktë rreth databazës së tatimit të pronë. Kjo mund të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja 5 – Parregullsi në kalkulimin e të hyrave

- E gjetura** Në tri raste komuna nuk ka bërë vlerësimin tatimor të pronës sipas zonave tatimore të përcaktuara në rregullore. Rruga “Haradin Bajrami” sipas rregullores është e përcaktuar si zonë e parë ku baza e vlerësimit të pronës për m² është 400€ për banim dhe 600€ për komerciale-dyqan. Komuna i ka vlerësuar 300€ për banim dhe 400€ për komerciale-dyqan, duke nënvlerësuar të hyrat mbi 40% në raport me tarifatat e përcaktuara më rregullore.
- Rreziku** Mangësitë e identifikuar ndikojnë në nënvlerësimin e të hyrave të komunës dhe realizim të dobët të projekteve (që financohen nga të hyrat) për qytetaret.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur sistemet e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat vlerësohen sipas rregulloreve përkatëse të aprovuara në kuvendin komunal.

Çështja 6 – Parregullsi në shqyrtimin e kërkesave për leje të ndërtimit dhe mjedisore

- E gjetura** Në një rast “konkluzioni mbi kompensimin për lëshimin e lejes së ndërtimit” (kalkulimi i taksës administrative dhe tarifës për rritje të densitetit) nuk është nënshkruar nga tre personat përgjegjës si dhe komuna ka lëshuar lejen mjedisore pa pranuar pagesën paraprakisht.
- Kërkesës për leje të ndërtimit i bashkëngjitet edhe leja mjedisore komunale si provë para se të shqyrtohet kërkesa. Në një rast raporti shqyrtues i komisionit për leje mjedisore dhe lejen mjedisore si dokument ishin lëshuar/ofruar pas dhënies së lejes së ndërtimit.
- Rreziku** Veprime e tilla mund të shkaktojnë parregullsi ligjore si dhe të rrisin rrezikun e mos inkasimit apo vonesës në inkasimin e të hyrave nga lejet mjedisore.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me menaxhimin e procesit për leje ndërtimi dhe që kontrollet janë ridizajnuar për ta adresuar problemin. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që të respektohet kronologjia e proceseve dhe komuna mos të ofrojë shërbim pa u kryer pagesa.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Shpenzimet për vitin ishin 8,650,049€ apo shprehur në përqindje 98% e asaj që është buxhetuar.

Çështja 7 - Dobësi në procesin e rekrutimit

E gjetura

Komuna nuk kishte respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara për menaxhimin e procedurave të rekrutimit, përfshirë edhe formularët standard të tyre. Anashkalimi i procedurave të rregullta të rekrutimit në shumicën e rasteve është si pasojë e neglizhencës së zyrtareve. Dobësisë e identifikuar i kemi prezantuar si në vijim:

- Në dy raste të rekrutimit për stafin civil për pozitat “Zyrtar për kadastër” dhe “Zyrtar prokurimi”, komuna nuk ka ofruar dëshmi lidhur me ftesën apo njoftimin e kandidateve për testim me shkrim apo interviste. Gjithashtu, tek këto raste mungonte edhe shkresa e menaxherit të personelit mbi rezultatin e testimit, për kandidatët e suksesshëm që i propozon Zyrtarit Kryesor Administrativ;
- Në rastin e rekrutimit për “Zyrtar për kadastër” nuk ka dëshmi mbi kërkesën për fillimin e rekrutimit nga udhëheqësi i njësisë. Për më tepër komuna në shpalljen publike, nuk ka specifikuar qartë kualifikimin, mirëpo është kërkuar vetëm “Diplomë Universitare”;
- Procedurat e përzgjedhjes së kandidateve në dy raste për pozitat “Doktor në Ambulanten Sillovi” dhe “Teknik i farmacisë në QMF-Lipjan”, testi me shkrim përmbante vetëm pesë pyetje dhe për më tepër mungonin dëshmitë me shkrim për komunikim me aplikuesit. Gjithashtu nuk është respektuar afati kohor i ankesave prej 15 ditëve (kontratat ishin nënshkruar pas një jave nga raporti final i rekomandimit të komisionit rekrutues);
- Për rekrutimin e tre mësimdhënësve, komuna nuk ka zhvilluar testimin me shkrim, si dhe komisioni është përberë vetëm prej tre anëtareve, kërkohet që komisioni të përbehet nga pesë anëtar. Për më tepër, te rekrutimi “Mësimdhënës të edukatës fizike në SHML Gjimnazi Ulpiana”, nuk është respektuar afati i ankesave prej 15 ditëve, ndërsa te rekrutimi “Arsimtar i Historisë - SHFMU Kadri Beba konkursi ka mbet i hapur vetëm për shtatë ditë;
- Në një rast, mungon opinioni i departamentit të buxhetit të MF-së për pozitën “Mësimdhënës i Edukatës Fizike në SHML Gjimnazi Ulpiana” e cila siguron se pozita është e planifikuar dhe është e aprovuar. Me

tutje, komuna në shpalljen publike ka kërkuar vetëm një mësimdhënës ndërsa janë pranuar dy; dhe

- Në konkursin e shpallur me 02.11.2017 për pozitat, SHFMU “Ernest Koliqi” - Arsimitar i gjuhës angleze, si dhe SHML “Gjimnazi Ulpiana” - Profesor i gjuhës gjermane, Drejtoria Komunale e Arsimit ka themeluar komisionin për interviste të kandidateve me 25 ditë me vonesë, në kundërshtim me nenin 7 të UA 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në sektorin Publik. Për me tepër kjo drejtori me rastin e themelimit të këtij komisioni është thirrur në Udhëzimin Administrativ që është shfuqizuar kohë më parë.

Rreziku

Komuna rrezikon menaxhim jo adekuat të burimeve njerëzore e cila rezulton me pranim të punonjësve jo kompetent për pozitat adekuate. Informatat jo të plota, mos respektimi i afateve kohore dhe kërkesave që dalin nga rregullat përkatëse lidhur me shpalljen dhe themelimit e marrëdhënies së punës mundësojnë ndërhyrje të parregullta në proceset rekrutuese dhe kontrolle jo adekuate me rastin e pranimit të punonjësve të ri.

Rekomandimi 7

Kryetari duhet t’i rishikojë shkaqet që kanë reflektuar menaxhim jo të mirë të burimeve njerëzore, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 është 1,213,884€. Prej tyre, ishin shpenzuar 1,091,909€ apo 90% e buxhetit.

Çështja 8 – Dobësi në procesin e prokurimit

E gjetura

Ne kemi identifikuar dobësi në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit si:

- Ekziston një numër i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale për t’iu shmangur aplikimit të procedurave të hapura. Komuna gjatë vitit 2017 ka lidhur 85 kontrata me vlerë minimale në vlerë totale 55,308€. Fakti që 85 kontrata ishin me vlerë minimale, flet për një vlerësim të dobët të nevojave nga njësitë kërkuese për prokurimin e furnizimeve me mallra dhe shërbime;
- Të procedura e prokurimit “Furnizimi me dru për ngrohje për shkollat, QKMF-në dhe shtëpinë e kulturës me pelet” në vlerë 123,821€ njoftimi për nënshkrimin e kontratës është publikuar me datën 03.10.2017, ose 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës (04.09.2017). Pra komuna nuk kishte vepruar sipas Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik, (neni 22,

pika G), që përcakton aftin dy ditor për bërjen publike të këtij njoftimit (pas nënshkrimit të kontratës); dhe

- Në dy raste deklarata e nevoja dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve, për prokurimet “Furnizime me ushqime për QEAP – Çerdhja Lipjan” dhe “Ditëve të shkollave” në vlerë 82,473€, janë nënshkruar nga zyrtaret përgjegjës 10 ditë pas raportit të vlerësimit të tenderit. Sipas Udhëzuesin Operativ të Prokurimit (neni 8), nënshkrimi i deklaratës kërkohet të behet para inicimit të aktivitetit të prokurimit, me të cilën Zyrtari Kryesor Administrativ, formalisht autorizon inicimin e aktivitetit të prokurimit.

Rreziku

Numri i lartë i kontratave me vlerë minimale rrit rrezikun që të dëmtohet konkurrenca e tregut dhe komuna të kontraktoj mallra, shërbime dhe punë me çmime më të larta sesa mund të ofrojë konkurrenca e hapur. Mos respektimi i kërkesave ligjore mund të rezultojë në vlerë të dobët për para dhe pagesa të parregullta. Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, rezulton në vonesa zbatimit të kontratave dhe rritjen e obligimeve të papaguara.

Rekomandimi 8

Kryetari duhet të siguroj kontrollë shtesë në procesin e prokurimit, në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Gjatë procesit të planifikimit duhet të behen analiza të mjaftueshme mbi nevojat për mallra dhe shërbime dhe të aplikojë procedura të hapura të prokurimit. Tutje të sigurojë që blerjet të behen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Për vitin 2017, buxheti për subvencione dhe transfere ishte 335,022€ dhe deri në fund të vitit komuna kishte shpenzuar 259,094€ apo 77%e buxhetit. Nivel jo i kënaqshëm ekzekutimit të buxhetit, kryesisht ka ndodhë për shkak se programi për subvencionimin e bujqësisë nuk është realizuar sipas parashikimeve. Lidhur me nivelin e ulët të realizimit të buxhetit në këtë kategori në kemi rekomanduar në kapitullin 3.1.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale në vitin 2017 ishte 4,495,597€. Prej tyre, janë shpenzuar 3,741,768 € apo 83% e buxhetit.

Çështja 9 – Dobësi në prokurim dhe menaxhim të kontratave

E gjetura Ne kemi identifikuar disa dobësi në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit për kategorinë e investimeve kapitale si në vijim:

- Prokurimi për projektin “Asfaltimi i rrugës nga Dobratini – Sllovi dhe Rrugës së Kuqe në fshatin Sllovi” në vlerë 14,755€, është realizuar jashtë planit të prokurimit, si dhe punët për asfaltimin e rrugëve janë kontraktuar në sezonin e dimrit që ka bërë të pamundshme realizimin e kësaj kontrate. Njoftimi për kontratë është shpallur me 09.10.2017 ndërsa kontrata është nënshkruar me Operatorin fitues me datën 15.11.2017 me plan për përfundimin e punimeve deri me 20.12.2017. Për shkak të kushteve atmosferike, menaxheri i kontratës ka njoftuar se kontrata nuk mund të realizohet brenda afatit dhe punimet janë shtyrë për vitin e ardhshëm;
- Te procedura e prokurimit “Ndërtimi i shkollës SHFMU - Neze Bujani - Bujan paralele e ndarë Bregu i Zi” me vendim dhe plan për menaxhimin e kontratës, organ mbikëqyrës është caktuar një zyrtar nga Departamenti Shërbimeve Publike, mirëpo raportet e mbikëqyrjes (situacionet e punëve të kryera) janë të nënshkruara nga dy zyrtarë tjerë nga ky sektor. Nuk ka vendim tjetër për ndërrimin e organit mbikëqyrës, dhe as plan të ri për menaxhimin e kontratës;
- Në katër⁵ raste departamenti i prokurimit ka aprovuar kërkesat e menaxherëve të kontratës për zgjatje të afatit të punimeve. Po ashtu në katër⁶ raste tjera ka aprovuar ndryshime edhe në paramasë. Këto ndryshime, nuk janë kryer në përputhje me Udhëzuesin Operativ të Prokurimit sipas neni 61.23, ku kërkohet që vetëm Zyrtari Kryesor Administrativ, paraprakisht të aprovoj këto ndryshime; dhe
- Në dy raste komuna ka shpall fitues Operatorin Ekonomik që nuk ka përmbushur kriteret e caktuara në dosjen e tenderit (kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale). Te projekti “Ndërtimi i shkollës fillore, Neze Bujani - Bujan, paralele e ndarë Bregu i Zi” është kërkuar një inxhinier i arkitekturës, ndërsa Operatori ekonomik fitues ka sjellë

⁵ “Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Gadime e Ulët - Faza 2”, “Përfundimi i punimeve në sallën e sportit - Dobrajë e Madhe”, “Asfaltimi i rrugës në fshatin Resinoc” dhe “Ndërtimi i qendrës rinore Magure - Faza II”.

⁶ “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jeta e Re”, “Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Mirenë - Faza II”, “Trotualet (Bashkëfinancim me donator) - Fshati Bujari” dhe “Renovimi i shkollave në Rufc i ri, Babush dhe rregullimi i oborrit të shkollës në Blinajë”.

diplomën bachelor i arkitekturës. Gjithashtu edhe tek prokurimi për “Ndërtimi i Zonës Ekonomike -Parku Industrial, në Qylagë - faza II” ishte kërkuar inxhinier i ndërtimtarisë ndërsa nga operatori fitues është sjell vetëm diploma për përgatitjen bachelor i ndërtimtarisë. Komuna nuk kishte vendosur kontrolle adekuate për formimin e komisioneve vlerësuese profesionale.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e parapara. Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me trajtim jo të barabartë të ofertuesve, pagesa të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë respektimin konsistentë dhe efektiv të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave, dhe të sigurohet që vlerësimi i tenderëve dhe shpallja e fituesve është në përputhje me kriteret e vendosura dhe ligjin e prokurimit publik.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Nga 62 pagesa të testuara për mallra dhe shërbime, si dhe investime kapitale vetëm 12 pagesa ishin realizuar me vonesë pas afatit prej 30 ditësh.

Nga 27 vendime gjyqësore në vlerë 129,229€, komuna ka paguar 23,012€ shpenzime shtesë për interes, shpenzimet kontestimore, përmbarimit etj.

Komuna nga 89 aktivitete të planifikuara të prokurimit ka nënshkruaj 80 kontratat apo 91%. Komuna në të gjitha rastet e testuara kishte emëruar menaxher të projektit sipas rregullave, si dhe përfundimi i punëve apo pranimi i mallrave, shërbimeve janë shoqëruar me raport të pranimimit nga komisioni për pranim teknik. Megjithatë, edhe me tutje mbetet sfida realizimi i këtyre kontratave të nënshkruara dhe ekzekutimi i punimeve në përputhje me kërkesat.

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 10 - Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës

- E gjetura** Në tri raste “Ndërtimi i shkollës SHFMU - Nezë Bujani - Bujan, paralele e ndarë Bregu i Zi” në vlerë 148,392€, “Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në komunën e Lipjanit” në vlerë 115,707€; dhe “Furnizime me ushqime për QEAP – Çerdhja Lipjan dhe ditëve të shkollave” në vlerë 82,473€, komuna ka bërë zotimin e mjeteve pas nënshkrimit të kontratës duke mos respektuar rregullën financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenin 12.
- Rreziku** Mos respektimi i kërkesave ligjore mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe vlerë të dobët për para. Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, mund të pasojë me vonesa në zbatimin e kontratave dhe rritjen e obligimeve të papaguara.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të siguroj kontrollë shtesë në procesin e prokurimit, në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Më tutje të sigurojë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme para hyrjes në obligime kontraktuale.

Çështja 11 - Ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit

- E gjetura** Në tri⁷ raste komuna nuk ka respektuar kërkesat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (neni 62.3) lidhur me ndarjen e duhur të detyrave gjatë procesit të prokurimit. Zyrtaret e njëjtë të cilët kishin përgatitur specifikacionin teknik janë angazhuar si menaxher të po atyre kontratave. Për më tepër, te procedura e prokurimit “Furnizime me ushqime për QEAP-Çerdhja Lipjan dhe ditëve të shkollave”, fillimisht menaxher i kontratës është caktuar zyrtari i cili ishte përfshirë në përgatitjen e specifikacionit teknik dhe në të njëjtën kohë ishte edhe anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit. Pas kërkesës zyrtare për lirim nga kjo detyrë, menaxher i kontratës caktohet një zyrtari tjetër, i cili po ashtu ishte anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit.
- Rreziku** Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që punët/shërbimet realizohen në harmoni me kushtet/specifikat e parapara në kontratë dhe ndarja jo e duhur e detyrave mund të shkaktoj konflikt interesi në menaxhimin e proceseve.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë efektive në zbatimin e proceduarve të prokurimit dhe menaxhimin e kontratave, dhe aplikoj masa për ndarje të duhur të detyrave në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.

⁷ Asfaltimi i rrugëve në fshatin Banullë”, “Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në Komunën e Lipjanit” dhe “Furnizime me ushqime për QEAP-Çerdhja Lipjan dhe ditëve të shkollave”

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna gjatë vitit 2017 ka prezantuar pasuri kapitale (mbi 1,000) në vlerë prej 168,686,958€ dhe pasuri jo kapitale (nën 1,000€) në vlerë 358,108€. Gjatë vitit, pagesat nga kategoria e investimeve kapitale janë ekzekutuara në vlerë 3,741,768€, ndërsa pasuria e regjistruar ishte 9,141,290€. Diferenca në mes të pasurisë së regjistruar dhe investimeve kapitale qëndron për faktin komuna ka regjistruar disa lokale afariste të cilat i takojnë komunës nga koncesionimi me operator ekonomik privat për ndërtimin e ndërtesave kolektive, pastaj donacionet dhe pranimet nga palët e treta.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.9 Të arkëtueshmet

Komuna e Lipjanit në fillim të vitin 2017 kishte të arkëtueshme në vlerë 3.32mil € ndërkaq vlera e prezantuar në fund të vitit është 3.96mil€. Rritja e të arkëtueshmeve është pasojë e mos inkasimit të rregullt të të hyrave nga tatimi në pronë si dhe të hyrat që priten të arkëtohen për shpronësimin e tokave komunale.

Çështja 12 – Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë

E gjetura Ne kemi identifikuar disa parregullsi gjatë kalkulimit të faturave për tatimin në pronë që nuk janë në përputhje të plotë me ligjin dhe rregullat në fuqi, si:

- Në tetë raste janë identifikuar gabime në adresat e evidentuara në faturën tatimore, ndonëse tatimpaguesit i takonin zonës së dytë, adresa e evidentuar në fatura i takon zonës së parë tatimore. Kjo pamundëson vlerësimin real të ngarkesës tatimore sipas rregullores;
- Në dy raste norma tatimore për kategorinë e pronës “depo/ magazine”, është aplikuar gabimisht norma 0.30% e jo 0.20% ashtu siç e parasheh rregullorja;
- Në katër raste janë vlerësuar gabimisht zona e vlerës tatimore. Pronat i takonin zonës së parë ndërsa ishin vlerësuar sipas zonës së dytë tatimore. Diferenca në këto raste ishte 112€;
- Në një rast, komuna ka njohur dy prona si banim kryesor të i njëjti tatimpagues, i cili kishte përfituar zbritjen prej 10,000€ në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit për Tatimin në Pronë. Kjo ka rezultuar me një nënvlerësim prej 31.35€ vetëm për vitin 2017; dhe
- Në dy raste tjera kategoria e pronës është aplikuar gabimisht. Tatimi është llogaritur sipas kategorisë “depo/magazine”, që realisht është

dashur të llogaritet sipas kategorisë “afarizëm/zyre”, kjo ka rezultuar me nënvlerësim të kërkesave/të arkëtushmeve rreth 15€.

Rreziku Mungesa e përditësimit të të dhënave dhe mos verifikimi i pronave të tatueshme, rritë rrezikun që ngarkesat tatimore të kalkuloohen në mënyrë jo adekuate dhe mund të rezultojnë me trajtim diskriminues të obliguesve tatimor.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për verifikimin dhe azhurnimin e të dhënave nga tatimi në pronë, për të siguruar që lista të jetë e përditësuar me të dhëna aktuale, pastaj të merr të gjitha veprimet e nevojshme për të azhurnuar të dhënat para përfundimit të vitit financiar 2018.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 499,375€. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja 13 – Menaxhim jo i duhur i obligimeve

E gjetura Në mesin e lëndëve që ishin subjekt i auditimit tonë për këtë periudhë ishin edhe dy⁸ fatura të prezantuara në raportin e obligimeve të pa paguara, të cilat përkundër kërkesës sonë të vazhdueshme, nuk na janë ofruar. Zyrtaret e komunës nuk ishin në gjendje t’i gjejnë këto fatura.

Fatura në vlerë prej 959€, e evidentuar në librin e protokollit me datë 21.12.2017 nuk është përfshirë në listën e obligimeve dhe e njëjta është paguar në shkurt të vitit 2018.

Rreziku Mos ofrimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara për auditim është në kundërshtim me legjislacionin³ dhe kufizon mundësinë e auditimit të rregullt për këtë zë të pasqyrave financiare. Gjithashtu mos prezantimi i plotë i faturave të pa paguara në PFV ndikon në nënvlerësimin e obligimeve.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet t’i rishikojë kontrollet mbi procesin e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve, si dhe prezantimit të tyre në raportet mujore të obligimeve të papaguara, përfshirë edhe shpalosjen e tyre në PFV. Gjithashtu duhet t’i identifikojë arsyet për mos ofrimin të dokumentacionit, si dhe siguroj mundësi me të mira të bashkëpunimit/ofrimit të dokumentacionit për realizim sa me përshtatshëm të auditimit sipas kërkesave ligjore në fuqi.

⁸ OE Standard Benz në vlerë 306€ dhe OE Ipko në vlerë 1,906€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Lipjanit ka rezultuar në 16 rekomandime. Komuna e kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, gjashtë rekomandime janë zbatuar; katër janë në proces të zbatimit dhe gjashtë nuk janë zbatuar ende.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 11 rekomandime (katër të pa zbatuara dhe shtatë të tjera ishin në zbatim sipër). Këto rekomandime nuk janë zbatuar ende dhe disa prej tyre përsëritën edhe në vitin 2017. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve të dhëna në dy vitet paraprake dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 - Zbatimi i ultë i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Përgatitja me kohë e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Komuna e Lipjanit, është mbështetur me një proces konfirmues në tetor të vitit 2017, se zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht. Mirëpo nga të dhënat në paragrafin më lartë shihet se shumica e rekomandimeve të viteve të kaluara ende nuk janë zbatuar.
- Rreziku** Përsëritja e disa prej rekomandimeve të vitit të kaluar dhe viteve të mëparshme edhe në këtë vit, tregon për dobësi të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet konsideroj aktivitete shtesë për të siguruar që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, monitorohet nga një grup i caktuar në nivel të Komunës, dhe raportohet në baza të rregullta kohore në lidhje me progresin dhe sfidat në zbatimin e tyre.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore në këtë fushë janë: llogaridhënia, efektiviteti i kontrolleve, menaxhimi i rreziqeve, pavarësia e auditimit të brendshëm, koordinimi i ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe zhvillimi i qeverisjes së mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Rishikimet tona lidhur me menaxhimin e të hyrave e dhe shpenzimeve kanë rezultuar me pajtueshmëri jo të plot me rregullat në disa raste si, menaxhim jo adekuat i kontratave, ndarja jo e duhur e detyrave, vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme, pagës e vonuar e obligimeve, mangësi në të hyra, vlera e lart e detyrimeve kontingjente të cilat kërkojnë trajtim të më tutjeshëm nga ana e menaxhmentit .

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës së Lipjanit veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, mbeten ende sfiduese për komunën.

Komuna posedon planet si: Planin zhvillimor Komunal 2013-2023, Planin Zhvillimor Urban 2013-2018, Planin kundër Korrupsionit 2016-2019, ndërsa në gusht të 2017 Komuna ka nxjerrë një vendim për Hartimin e Projektit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit për vitet 2018 - 2023.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në Komunën e Lipjanit është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) e cila operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy auditor.

Auditimi i brendshëm duhet të jetë i zhvilluar si një mjet i menaxhmentit për shtimin e vlerës jo vetëm duke raportuar parregullsitë individuale, por gjithashtu duke parandaluar gabimet sistematike, duke identifikuar fushat për përmirësim dhe duke promovuar praktikën më të mirë të menaxhimit.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin përfshirë të të auditime për vitin 2017. Plani i auditimit ishte përmbushur plotësisht duke përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara. Nga të të raportet e finalizuara, dy prej tyre kishin të bënin me aktivitetet e vitit 2016, ndërsa gjitha të të tjera përfshinin kryesisht vitin 2016 dhe disa muaj të vitit 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 15 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Menaxhimi jo adekuat i kontratave, ndarja jo e duhur e detyrave, vlerësimi i dobët i nevojave, mbikëqyrja e pamjaftueshme, vonesa në shlyerjen e obligimeve, dhe vlera e lartë e detyrimeve kontingjente nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Si rezultat i kësaj, disa prej projekteve as që kanë filluar për faktin që mjetet e dedikuara për to janë ekzekutuar nga MF për vendime gjyqësore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative.

Komuna ka hartuar regjistër të rreziqeve, mirëpo nuk ka përgatitë një strategji për menaxhimin e rrezikut. Edhe pse ekziston mundësia e përballjes me rreziqe, komuna nuk ka ndërmarr veprime të nevojshme për të përgatitë ndonjë politikë, procedurë apo raport se si do të menaxhohen rreziqet, në veçanti rreziku i mashtrimit dhe parregullsive.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, duhet të siguroj se planifikohen dhe ndërmerren masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim.	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime.		PFV kane rezultuar me disa gabime, të cilat edhe pse janë korrigjuan brenda afatit ligjor, ende figurojnë me disa parregullsi.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak.	Kryetari duhet të siguroj se plani i veprimit po zbatohet me kohë për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me një rëndësi më të madhe, duke marr veprime aktive në zbatimin e plotë të tyre. Progresi duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.		Komuna kishte hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mbetur të pa zbatuara ose në proces të zbatimit.	
2.2 Pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së.	Kryetari duhet të siguroj që të delegohet përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësisve do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet. Të bëhet monitorimi i strategjisë për t'u sigurua se janë duke u arritur objektivat.	Po		

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike.	Kryetari duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin sistematik të arritjes së objektivave strategjike, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm (Zbatimi i rekomandimeve të NjAB).	Kryetari duhet të siguroj hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. Komiteti i auditimit në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimit të brendshëm.	Po		
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari të siguroj se me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i buxhetit për të siguruar përmirësimet e duhura në ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale për vitin 2017. Një monitorim sistematik i trendëve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.		Pjesërisht është zbatuar pasi edhe këtë vit, komuna nuk ka arrit të ekzekutoj buxhetin në nivelin e parashikuar për të gjitha kategoritë.	
3.1.1 Të hyrat e hyrat	Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart (1//3 e pronave), Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me Udhëzimet administrative dhe ligjet.			Nuk janë marrë masa.

3.1.1 Të hyrat e hyrat	Kryetari duhet të siguroj se do të rishikohen kontratat për qiradhënie dhe do të hartohet një plan masash ku do të përcaktohen afatet kohore shtesë për kryerjen e pagesave dhe përgjegjësit për zbatimin e masave të propozuara në mënyrë që të mblidhen borxhet e mbetura, si dhe në baza të rregullta të inkasohen borxhet aktuale.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat e hyrat	Kryetari duhet të analizoj pse rastet e tilla kanë ndodhur, të bëj korrigjimet e duhura si dhe të forcoj kontrollet që sigurojnë respektimin e tarifës për lëshimin e lejeve të ndërtimit.	Po		
3.1.1 Të hyrat e hyrat	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e ngarkesës me taksë për leje të ndërtimit të ushtroj kontrolle të duhura dhe të zbatoj rregulloren për taksat në lejet ndërtimore, në mënyrë që të mos i dëmtoj financiarisht operatorët ekonomik, dhe se të gjitha taksat për leje ndërtimi paguhen para se të lëshohen lejet.		Përkundër përmirësimeve, edhe në vitin 2017 janë identifikuar raste të parregullsive në menaxhimin e të hyrave nga lejet e ndërtimeve.	
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se përfituesit e subvencioneve do të raportojnë për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të përfituara në pajtim me kërkesat e rregullores në fuqi.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se drejtoria e prokurimit do të marr masat e duhura që para fillimi të secilës procedurë të prokurimit për punë/ndërtim, të zbatoj kërkesat për hartimin e projekteve ekzekutive të ndërtimit.	Po		

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet vendos kontrollle rigoroze mbi mbikëqyrjen e projekteve në mënyrë që të gjitha pagesat të bëhen në bazë të punëve të përfunduara dhe të kontraktuara.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të procedurave të prokurimit, të nënshkruhet deklarata e disponueshmërisë së mjeteve si dhe zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, Kryetari duhet të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin për kryerjen e borxheve ndaj furnitorëve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve			Nuk janë marrë masa.

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Ka rekomandime përsëriten nga viti në vit.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se do krijohen procedura formale për menaxhimin e rrezikut për organizatën në mënyrë, të përcaktoj dhe ndërmerr veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike.	Po		
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet edhe më tutje të fuqizoj mekanizmat që rekomandimet e NJAB, të adresohen dhe të siguroj se komiteti i auditimit është vazhdimisht aktiv në shqyrtimin e çështjeve të dala nga auditimi dhe të nxitë përmirësimin e aktiviteteve operative dhe financiare të komunës. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit të hartoj statutin ku specifikohet fushëveprimi dhe objektivat, dhe mbi këtë të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.	Po		

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet brenda kategorive ekonomike, dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat për ekzekutimin maksimal të buxhetit.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen vendosur kontrole të shtuara tek mbikëqyra e projekteve në mënyrë që punimet të kryhen sipas paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar.		Pjesërisht i zbatuar, disa të gjetura përsëriten prapë.	
	Kryetari duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.		Komuna është në proces të përmirësimit të menaxhimit të proceseve të prokurimit, mirëpo edhe në këtë janë identifikuar disa parregullsi në këtë drejtim.	
3.4.2 Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të siguroj se do ketë raportim nga ana e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve si dhe subvencionimi në fushën e bujqësisë të bëhet në mënyrë të hapur duke vendosur kritere të qarta.	Po		

3.5 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Veprime shtesë ka nevojë të ndërmerren për të siguruar se tatimet mblidhen në nivelet e parashikuara dhe verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet me ligj.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se nuk do shfrytëzohet prona komunale pa kontrata valide. Këtë duhet ta rregullojë përmes organizimit të ankandit publik sipas ligjit mbi shfrytëzimin e pronës komunale.	Po		
3.5 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se para se të lëshohet leja e ndërtimit, fillimisht të kryhen të gjitha obligimet nga ana e aplikuesit të ndërtimit, e pastaj të lëshohet leja e ndërtimit.		Ne kemi verifikuar një rast ku leja mjedisore ishte lëshuar para se të kryhet pagesa.	
3.6.2 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar do procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë me rregullën e thesarit nr.02/2013, si dhe për kontratat që janë nënshkruar nga vitet e kaluara pa zotime të mjeteve të planifikoj buxhet në mënyrë që të kryhen obligimet me kohë. Ne sugjerojmë që me rastin e planifikimeve buxhetore, Kryetari i Komunës duhet ta diskutoj dhe zgjidhë këtë problem me Qeverinë, përkatësisht me Ministrinë e Financave.		Pjesërisht i zbatuar, ende ka fatura që paguhen pasi të kalon afati i rregullt prej 30 ditësh.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



Komuna e Lipjanit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës,

Data: 17.05.2018, Lipjan,

